



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 519 Prot.

Tiranë më 11.05.2020

REKOMANDIM

Nr. 02, datë 11.05.2020

**PËR PUBLIKIMIN E “POLITIKAVE TË PRIVATËSISË” NË FAQET
ZYRTARE NGA INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE**
*(Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale
nga organet e administratës shtetërore)*

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31, pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të organeve të administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e kontrolluesve dhe në përmbushje të respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e këtij sektori;

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e aktivitetit të administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë në kuadër të impaktit që ka mbi qytetarët përpunimi i të dhënave personale nga ana e saj, në lidhje me ushtrimin e detyrave funksionale, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse nga ana e kontrolluesve që veprojnë në këtë sektor.

Në nenin 2, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, përcaktohet se: “1. Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore”... “3. Administrata shtetërore ka personalitet juridik publik dhe përbëhet nga struktura të organizuara në mënyrë hierarkike”.

Në nenin 4 të ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, janë parashikuar edhe institucionet që përbëjnë administratën shtetërore:

Kryeministria; ministrinë; institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave; njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve; agjencitë autonome dhe administrata e prefektit.

Këto institucione konsiderohen subjekte përpunues të mëdhenj në kuptim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”* dhe si të tilla, kanë detyrim plotësimin e të gjithë parashikimeve që burojnë nga baza ligjore e sipërcituar për sa i përket të dhënave personale që ato përpunojnë.

Zyra e Komisionerit ka realizuar hetime administrative në institucione të administratës shtetërore, me objekt: *“Zbatimi i neneve 18 dhe 21 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.*

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, gjatë ushtrimit të hetimeve administrative në kontrolluesit e cituar më sipër, është konstatuar se:

➤ Një numër i konsiderueshëm kontrolluesish (*institucione të administratës shtetërore*) nuk kanë *“Njoftuar”* Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që kryejnë.

Detyrimi për njoftim dhe përditësimi i *“Formularit të Njoftimit”* është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin e të dhënave që kryen kontrolluesi dhe të ushtrojnë në mënyrë korrekte të drejtat që u jep ligji. Mospërbushja e detyrimit për njoftim përbën shkelje të neneve 21, 22 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar. Përditësimi ka të bëjë me faktin se detyrimi për njoftim nuk mund të konsiderohet i përfunduar dhe i pandryshueshëm në kohë, por ekziston në çdo rast kur ndryshon një nga elementët e *“Formularit të Njoftimit”*.

➤ Në portalet zyrtare të kontrolluesve (*institucione të administratës shtetërore*) nuk ishin vendosur politikat e privatësisë. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar.

Çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale dhe pavarësisht nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet portalit online në internet, ka detyrim që të publikojë *“politikat e privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet portalit zyrtar të kontrolluesit. Informacioni i publikuar në *“politikat e privatësisë”*, duhet të informojë subjektet e të dhënave që vizitojnë këtë portal, në lidhje me fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, kategoritë e të dhënave që përpunohen, të drejtat e subjekteve të të dhënave si dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë;

Zyra e Komisionerit vlerëson se mospublikimi i “politikave të privatësisë” në faqen e internetit, nuk i jep mundësi subjektit të të dhënave personale për të drejtën për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV “Të drejtat e subjektit të të dhënave”, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu, kontrolluesit rezervon të drejtën dhe detyrimin që të ndryshojë apo modifikojë këtë politikë privatësie, në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit specifik dhe atij në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

- Ministritë e linjës, dhe institucionet/agjencitë e tyre të varësisë, kanë në administrim portale zyrtare nëpërmjet të cilave i ofrojnë individëve mundësi për të kontaktuar me institucionin, si dhe shërbime specifike nëpërmjet depozitimit të kërkesave apo edhe administrimin e ankesave. Në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, këto institucione janë kontrollues të të dhënave personale, dhe detyrohen të informojnë qytetarët të cilët kontaktojnë institucionet nëpërmjet faqeve të internetit, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale që administrohen gjatë këtij procesi.

Rregullorja 2016/679/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 27 prill 2016 mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (GDPR), e cila ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2018, në nenet 13 dhe 14, i kushton një rëndësi e veçantë transparencës së institucioneve dhe detyrimin për të informuar qytetarët mbi përpunimin e të dhënave të tyre personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e zbatimit të legjislacionit kombëtar mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe përafrimin e tij me atë të Bashkimit Evropian.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 21, 22, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, në faqet online të institucioneve të publikohen në një rubrikë të veçantë “politikave të privatësisë”, ku të përfshihet informimi i subjekteve të të dhënave si dhe kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Për plotësimin e këtij detyrimi mund t’i referoheni Opinionit të Komisionerit “Mbi mbrojtjen e të dhënave personale në faqen e internetit të kontrolluesve publik dhe privat”, i publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit në adresën www.idp.al rubrika ‘legjislacion/opinione’. Gjithashtu, edhe pas publikimit të tregohet kujdes në ndryshimin apo modifikimin e kësaj rubrike në zbatim të çdo ndryshimi të mundshëm të legjislacionit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale apo legjislacionin specifik.

2. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, të plotësohet detyrimi për njoftim nga kontrolluesit të cilët nuk e kanë zbatuar këtë detyrim për herë të parë si dhe të tregohet kujdes në vijimësi, në përditësimin e njoftimit për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit, të njoftuar më parë.
3. Ministrinë e linjës të marrin masa për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij rekomandimi, në portalet e tyre zyrtare, si dhe të institucioneve të tyre të varësisë.
4. Të njoftohet me shkrim pranë Zyrës së Komisionerit mbi masat e marra në zbatim të Rekomandimit të mbështetura nga veprimet përkatëse. Plotësimi i këtij detyrimi ligjor mund të jetë edhe objekt hetimi administrativ në të ardhmen.
5. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 11.5.2020

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

